

Kryepiskopata e Aradit i dhuron 8.000\$ pavionit të Pediatriisë në spitalin e zonës



Së shpejti, pavionit të Pediatriisë së spitalit të Aradit do t'i dhurohet një shumë prej 8.000\$ (34.774 lei) nga Kisha Orthodhokse e Rumanisë.

Sipas raportimeve të Zyrës së Shtypit të Kryepiskopatës së Aradit, shuma e lartpërmendur u mbledh falë një koncerti bamirësie të zhvilluar në Pallatin e Kulturës së qytetit më 22 Janar të këtij viti.

Në koncert mori pjesë dhe Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi Timothe i Aradit dhe Hirësia e tij, Episkopi Emilian i Crişanit dhe të tjerë zyrtarë.

Performoi në të disa kore fëmijësh, një orkestër dhe shumë të tjerë.

Raporti i Zyrës së shtypit konkludon si vijon: “ Falënderojmë Perëndinë dhe të gjithë sa vlerësojnë ofrimin e Kishës në shërbimet komunitare, për fëmijët dhe të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmën tonë”.